



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:263217

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352821

K.DH.SH.II.nr.1535/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Conex Group” Sh.P.K., me NUI: 70464055, me seli në Gurakoc, Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson pronari D.F.i, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Erëlehta Popaj nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ – përkatësisht anulim i Vendimit PSH.nr.728/18 të datës 13.12.2018, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.96/22 të datës 25.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.96/22 të datës 25.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktgjykimin KA.nr.96/22 të datës 25.09.2023, (tani e tutje: “aktgjykimi i ankimuar”), në tërësi ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Conex Group” Sh.P.K., me seli në Gurakoc, Komuna e Istogut, (tani e tutje: “paditësi”), ashtu që ka anuluar Vendimin PSH.nr.728/18 të datës 13.12.2018, (tani e tutje: “akti i kontestuar administrativ”), të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, (tani e tutje: “i padituri”) si i pabazuar dhe çështjen e ka kthyer tek i padituri për rivlerësim dhe rivendosje. Dhe me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar është vendosur që secila palë ndërgjyqëse t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë i padituri për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë të aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurit, ashtu që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe Vendimi PSH.nr.728/18 i datës 13.12.2018, përkatësisht akti i kontestuar administrativ i të paditurit të mbetet në fuqi.
3. Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.
4. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:
 - Ankesa është e pabazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi brenda afatit ligjor pranë Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurit për inicimin e konfliktit administrativ, me kërkesë për anulimin e aktit të kontestuar administrativ të të paditurit si të kundërligjshëm, me arsyetimin se përmes këtij akti administrativ i padituri, si shkallë e dytë në procedurë administrative, padrejtësisht ka hedhur poshtë ankesën e paditësit si të palejuar, dhe po ashtu i padituri me këtë akt administrativ ka shpallur paditësin operator ekonomik të papërshtatshëm profesionalisht për shkelje të rënda profesionale sipas nenit 65, para. 3, pika 4 të LPP-së, gjë që e ka kualifikuar paditësin si palë pa interes juridik material konform nenit 4, para. 1.26 të LPP-së, përkitazi me nenin 111, para. 1-8 të LPP-së. Po ashtu, sipas paditësit, me këtë akt të kontestuar administrativ i padituri ka lejuar Autoritetin Kontraktues të vazhdojë tutje me procedurat e prokurimit publik nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër. Ndërsa, Autoriteti Kontraktues përmes Njoftimit për dhënie të kontratës të Ministrisë së Infrastrukturës (tani e tutje: “Autoriteti Kontraktues”) me numër të prokurimit 17-071-211 Peja 2 ka shpallur fitues të thirrjes operatorin ekonomik “Granit” Sh.P.K., me seli në Istog, gjë që i ka shkaktuar dëme paditësit. Për këto arsye, paditësi ka konsideruar që akti i kontestuar administrativ i të paditurit është i pabazuar dhe se i njëjti duhet të anulohet. Po ashtu, paditësi ka kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.
6. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë e shkallës së parë, pasi ka administruar provat e propozuara, mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar, në Aktgjykimin e saj KA.nr.96/22 të datës 25.09.2023, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.
7. Gjykata e shkallës së parë pasi ka bërë vlerësimin e provave të administruara, pretendimeve të palëve dhe shkresat e lëndës në këtë konflikt administrativ, ndër të tjera, ka ardhur në konstatimet si në vijim:

- 7.1. Me Vendimin PSh.nr.728/18 të datës 13.12.2018 të Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përkatësisht me aktin e kontestuar administrativ të të paditurit, është hedhur poshtë si e palejuar ankesa e paditësit në cilësinë e operatorit ekonomik aplikues, kundër eliminimit të tij lidhur me aktivitetin e prokurimit publik me titull: “Mirëmbajtje verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019”, me numër të prokurimit: 17-071-211 Lot Pjesa 2, inicuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës, me arsyetimin se paditësi në cilësinë e operatorit ekonomik ka qenë i papërshtatshëm profesionalisht për shkak të shkeljeve të rënda profesionale, sipas nenit 65, para. 3, pika 4 të LPP-së. Sipas konstatimit të këtij akti të kontestuar administrativ thuhet se në rastin konkret kemi aktgjykim dënues nga Gjykata Themelore në Prishtinë për personin me inicialet V.F. – pronarin e biznesit “Conex Group” Sh.P.K., me të cilin aktgjykim personi në fjalë është shpallur fajtor për veprën e falsifikimit, mashtrimit, dhe deklarimit të rremë nën betim, fakt ky i konstatuar me Vendimin nr. 518/18, 528/18, 531/18 të datës 23.10.2018 të OSHP-së, në këtë rast të të paditurit. Sipas të paditurit, këto kanë qenë arsye se përse paditësi është vlerësuar si palë pa interes juridik material konform nenit 4, para. 1.26 të LPP-së, përkitazi me nenin 111, para. 1-8 të LPP-së;
- 7.2. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se shkak kryesor dhe i vetëm i eliminimit të paditësit nga aktiviteti i prokurimit publik sipas Vendimit PSh.nr.728/18 të datës 13.12.2018, përkatësisht sipas aktit të kontestuar administrativ të të paditurit, është i pabazuar sepse ky shkak nuk është vërtetuar me asnjë provë. Në këtë drejtim: së pari, nuk është vërtetuar identiteti i personit të dënuar ku në këtë akt të kontestuar administrativ i padituri i referohet këtij personi me inicialet V.F., e që nuk përputhet me inicialet e asnjërit pronar të “Conex Group” Sh.P.K., ku sipas Çertifikatës së biznesit me nr. 70464055, me datë regjistrimi 19.12.2017, pronarë të biznesit “Conex Group” Sh.P.K. janë D.F.i dhe Elvane Fetahi Selmanaj; së dyti, i padituri në këtë akt të kontestuar administrativ nuk ka arsyetuar se çfarë pozite ka personi me iniciale V.F. në “Conex Group” Sh.P.K., në këtë rast operator ekonomik i eliminuar; dhe së treti, i padituri nuk e ka bashkëngjitur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 23.10.2018. Për t’a vërtetuar këtë fakt, Gjykata e shkallës së parë ka verifikuar të dhënat e personave të dënuar dhe për D.F.i dhe Elvane Fetahi Selmanaj ka konstatuar se të njëjtit nuk janë të dënuar për ndonjë veprë penale;
- 7.3. Akti i kontestuar administrativ i të paditurit nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që në faktet e vërtetuara është nxjerrë nga i padituri një konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, rrethana këto që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Për këto arsye, Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë dhe ka anuluar aktin e kontestuar administrativ të të paditurit;
- 7.4. Më tutje, Gjykata e shkallës së parë ka udhëzuar të paditurin që në rivlerësim të çështjes duhet të vërtetoj shkakun kryesor të mbështetur në prova për të cilin paditësi është eliminuar dhe duhet të përcaktojë se çfarë pozite mbanë personi me iniciale V.F. në

“Conex Group” Sh.P.K., sepse në aktin e kontestuar administrativ të të paditurit kemi të bëjmë me iniciale që nuk përputhen me inicialet e pronarëve – gjë që është në kundërshtim me arsyetimin e këtij akti administrativ.

8. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi: aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së; në aktgjykimin e ankimuar është bërë konstatimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike; dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.
9. Kolegji i kësaj gjykate, sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gjeti se në ankesë nuk ekziston ndonjë pretendim ankimor që është i argumentuar dhe i shoqëruar me ndonjë bazë juridike. Gjithsesi, Kolegji i kësaj gjykate nga shqyrtimi i bërë në ankesë, aktgjykimin e ankimuar, dhe shkresat e tjera të lëndës gjeti se Gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Po ashtu, Gjykata ankimore gjeti se ndërmjet shkresave të lëndës dhe gjendjes së konstatuar faktike me aktgjykimin e ankimuar nuk ekziston ndonjë mospërputhje. Si rrjedhojë, Gjykata ankimore pretendimet ankimore të të paditurit në lidhje me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike i vlerësoi si pretendime të pabazuara.
10. Në këtë drejtim, Gjykata ankimore vlerësoi se identifikimi i saktë i personit me inicialet V.F. dhe konstatimi i saktë i raportit të tij me paditësin, e bashkë me të konstatimi i saktë i statusit të tij që ai apo ajo eventualisht mund t’ a ketë tek paditësi, për të paditurin, si organ i shkallës së dytë në procedurë administrative, kanë paraqitur kushte imperative për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, vetëm pas plotësimit të të cilave kushte i padituri do të mund të zbatonte saktë të drejtën materiale. Ndërsa Gjykata e shkallës së parë edhe pse në mënyrë të saktë i ka vërejtur këto mangësi, ajo e ka pasur plotësisht të pamundur në bazë të shkresave të lëndës ndriçimin e këtyre rrethanave faktike, pa të cilat assesi nuk mund të nxirret një vendim i saktë meritore për këtë çështje juridike administrative. Përkatësisht, Gjykata e shkallës së parë e ka pasur plotësisht të pamundur identifikimin e personit me inicialet V.F., për arsye se i padituri edhe pse e ka përmendur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 23.10.2018, të njëjtin nuk i’ a ka parashtruar Gjykatës së shkallës së parë, sikurse nuk i’ a ka parashtruar edhe Gjykatës së shkallës së dytë nëpërmjet ankesës. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë me plotë të drejtë dhe në mënyrë të saktë ka udhëzuar të paditurin, si organ të shkallës së dytë në procedurë administrative, se si duhet të veprojë përgjatë rivlerësimit dhe rivendosjes në këtë çështje.
11. Gjykata ankimore gjeti se përderisa i padituri pretendon se ka pasur të drejtë të nxjerrë aktin e kontestuar administrativ përmes të cilit ka shpallur si profesionalisht të paaftë paditësin në aktivitetin e prokurimit publik dhe po ashtu ka shpallur paditësin si palë pa interes juridik në

këtë aktivitet të prokurimit publik, i njëjti ka pasur dhe ka për detyrim ligjor që t'i provojë faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta. Në këtë drejtim:

- 11.1. I padituri, si organ i shkallës së dytë në procedurë administrative, ka dhe ka pasur për detyrim ligjor në procedurë administrative provimin e fakteve mbi të cilat ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ, në bazë të nenit 90, para. 2 të LPPA-së i cili thekson: “... Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative”. Prandaj, të paditurit në rivlerësim dhe rivendosje të çështjes në procedurë administrative përsëri i takon barra e provës;
- 11.2. Duke u nisur nga neni 63 i LKA-së dhe duke marrë parasysh se paditësi i ka provuar të gjitha faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta në lidhje me faktin e të mosqenurit të pronarëve dhe të drejtorit të tij persona të dënuar penalisht në kuptim të nenit 7, para 1 dhe neni 319, para. 1 të LPK-së, në këtë rast të paditurit në këtë konflikt administrativ si palë ndërgjyqëse i ka takuar barra e provës në kuptim të nenit 322 dhe 331, para. 1 të LPK-së, të cilën nuk ka të drejtë t'a refuzojë në qoftë se vazhdon të mbështetë pretendimet e tij, në kuptim të nenit 334 të LPK-së. Ndërsa në këtë konflikt administrativ i padituri ka vazhduar t'i mbrojtë pretendimet e tij pa parashtrimin e provave përkatëse.
 - 11.2.1. Neni 63 i LKA-së: “Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore”;
 - 11.2.2. Neni 322 i LPK-së i cili thekson: “1. Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës; 2. Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër; ...”;
 - 11.2.3. Neni 331, para. 1 i LPK-së thekson: “Çdo palë ndërgjyqëse detyrohet kryesisht të paraqesë shkresat që ka përdorur për të provuar thëniet e veta”;
 - 11.2.4. Neni 334 i LPK-së thekson: “Pala nuk mund të refuzojë paraqitjen e dokumentit, po që se ajo vetë i është referuar dokumentit si mjet provues për thëniet, apo në qoftë se është fjala për dokumentin të cilin sipas ligjit ka për detyrë ta dorëzojë ose ta tregojë apo, në qoftë se dokumenti, duke marrë parasysh përmbajtjen e tij konsiderohet si i përbashkët për të dy palët”.
12. Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësuan se i padituri nuk mund të thirret në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 23.10.2018 si provë të pranueshme, përderisa të njëjtin nuk i'a ka parashtruar paditësit përgjatë tërë procedurës administrative, e aq më tepër kur të njëjtin nuk i'a ka parashtruar Gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së shkallës së dytë përgjatë zhvillimit të konfliktit administrativ.

13. Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurit në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, konstatuan se këto pretendime janë të pabazuara. Për më tepër, i padituri me pretendimet ankimore ka treguar se në cilat dispozita ligjore të së drejtës materiale është zbatuar për nxjerrjen e aktit të kontestuar administrativ të tij. Mirëpo, i padituri në pretendimet ankimore nuk sqaron se cilën dispozitë ligjore të së drejtës materiale e ka shkelur Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar.
14. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata ankimore erdhi në përfundim që Gjykata e shkallës së parë pasi ka bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, e njëjta ka zbatuar në mënyrë të saktë të drejtën materiale.
15. Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjeti se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje të konfliktit administrativ, prandaj në mbështetje të nenit 209, para. 1, pika (b) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1535/23 datë 24.09.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova